



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија" бр.5, 1000 Скопје | тел. 02/3218 130 факс. 02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel. 02/3218 130 faksi. 02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenin 9 paragrafi (1) nënparagrafi (1) n.l. me nenin 16 paragrafin (1) nga Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/2019) Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikon:

SH P A L L J E

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve që i përkasin një komuniteti që përbën më shumë se 20% të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në shpallje për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në listën e veçantë të kandidatëve të gjyqtarve mund të paraqiten qëro gjyqtar i cili në momentin e publikimit të shpalljes kryen funksion gjyqësor, i cili është nga radhët e gjyqtarëve të bashkësisë që përbën më shumë se 20% të popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe i plotëson kushtet e nenit 11 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 102/19)

-të ketë të paktën gjashtë vjet përvojë gjyqësore,
-të ketë një vlerësim pozitiv të punës në kryerjen e funksionit gjyqësor, dhe
-të mos i jetë shqiptuar me vendim të formës së prerë masa disiplinore e uljes së pagës në shumën prej 15% deri në 30% të pagës mujore që është në fuqi në kohën e publikimit të njoftimit.

Kandidati duhet të paraqesë me aplikimin:

-vërtetim për përvojë gjyqësore,
-të dhëna biografike për profesionalizim dhe zhvillim profesional,
-notimet për rezultatet e punës të dhëna nga Këshilli,
-të dhënat mbi pjesëmarrjen në arsimin profesional dhe profesional, të lëshuara nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, dhe
-deklaratë për cilën listë aplikon kandidati.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin kandidaturën me dokumente origjinale apo të verifikuara në Noter dhe dorëzojnë te Këshilli Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rr.Makedonia nr.5 në afat prej 15 ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Nr.02- 2324/1

19.11.2025

Shkup

**KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT
Kryetar**

м-р Александар Камбовски